

## **Perspektiva e Ballkanit Perëndimor: Kohët e Vështira Kërkojnë Ekonomizim të Mirë<sup>1</sup>**

**Ashtu si Evropa dhe pjesa tjetër e botës, edhe Ballkani Perëndimor parashikohet të kalojë në recesion gjatë vitit 2020, dhe shtrirja e tij do varet nga kohëzgjatja e pandemisë COVID-19.** Kjo krizë është një goditje e paprecedentë që ka kapur në befasi botën dhe ekonominë e saj. Ndërsa vendet adoptojnë masat e qëndrimit në shtëpi për të ngadalësuar dhe parandaluar përhapjen e virusit, qeveritë dhe shoqëritë po përballen me kostot e larta njerëzore, sociale dhe ekonomike. Deri më 25 Prill, numri i rasteve të konfirmuara me COVID-19 ishte më shumë se 2,800,000, në të paktën 180 vende të botës duke detyruar izolimin e më shumë se 3 miliardë njerëzve.<sup>2,3</sup>

**Në këtë situatë të paprecedentë, parashikimi ekonomik bëhet veçanërisht i vështirë për shkak të pasigurisë së lartë që vjen prej faktorëve të jashtëm, siç janë shkalla dhe ndikimi i ndërhyrjeve të tilla si izolimi social, progresi në zhvillimin e një vaksine, shkalla e shtrirjes së ndërprerjeve të furnizimit dhe ndryshimet në sjelljen njerëzore.** Parashikimet në këtë shënim bazohen në dy skenarë për përhapjen e COVID-19 dhe masat e kontrollit të tij. Skenari bazë supozon se përhapja në Evropë do fillojë të ngadalësohet me ritme të tilla që masat e kontrollit të tij mund të hiqen deri në fund të qershorit dhe rimëkëmbja graduale ekonomike mund të fillojë në gjysmën e dytë të vitit 2020. Në skenarin negativ, supozohet se përhapja vijon me ritme të tilla që masat e kontrollit nuk mund të hiqen para fundit të muajit gusht, dhe rikuperimi i aktiviteti ekonomik fillon vetëm në T4.

### **Rajoni i Ballkanit Perëndimor parashikohet të hyjë në fazë recesioni në vitin 2020, dhe magnituda e tij varet nga kohëzgjatja e shpërthimit të COVID-19**

**Sipas parashikimeve të skenarit bazë, recesioni do të ishte i ndjeshëm, me tkurrje të rritjes ekonomike të rajonit me rreth 3 përqind, por me diferenca të rëndësishme midis vendeve në varësi të strukturës ekonomike dhe dobësive të tyre në periudhën para-krizë.<sup>4</sup>** Bazuar në supozimin se përhapja e COVID-19 do të vihet nën kontroll nga mesi i vitit 2020 — duke mundur rinisjen e aktivitetit ekonomik pas heqjes së masave kufizuese për të kontrolluar përhapjen e virusit dhe lehtësimin të tregut financiar dhe ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit - rritja e PBB-së reale për gjithë vitin do të binte me 3.1 përqind. Për shkak se struktura e tyre ekonomike varet nga eksportet e shërbimeve dhe nga dobësitë fiskale dhe të jashtme, Mali i Zi, Shqipëria dhe Kosova do të përjetonin goditje më të fortë, me një rënie prej mbi 8 pikë përqindjeje (pp) krahasuar me parashikimet para-COVID-19 2020 (Figura 1). Ekonomitë e tyre parashikohet të kontraktohen me rreth 5 përqind. BH, Serbia dhe Maqedonia e Veriut pritet të përjetojnë recesione disi më të lehta me rënie prej 3.2, 2.5, dhe 1.4 përqind krahasuar me parashikimet e para-COVID-19.

**Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, recesioni do të vijë si rezultat i rënies së kërkesës së brendshme dhe të jashtme gjatë krizës COVID-19.** Masat globale dhe kombëtare të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së virusit, nga distancimi social deri në mbylljet e biznesit, krijojnë ndërprerje në anën e ofertës dhe zvogëlojnë të ardhurat dhe konsumin e familjeve - një goditje e dyfishtë kërkesë-

<sup>1</sup> Ky shënim i RRRë trajton ndikimin e COVID-19 në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor sipas skenarëve të ndryshëm për krizën. Një diskutim i hollësishëm i ndikimit të COVID-19 në fusha specifike ekonomike, sektorët socialë dhe ndikimet sociale në rajon do të jepet në shënime të veçanta të RRRë që do të publikohen në vijim të prezantimit elektronik.


<sup>2</sup> Përditësimi më 25 Prill; burimi: COVID-19 Tracker.

<sup>3</sup> Burimi: <http://dailym.ai/2UuMRCu>

<sup>4</sup> Ju lutemi shikoni gjithashtu "Harta e të dhënave për ndjeshmëritë relative ndaj COVID-19 të Ballkanit Perëndimor" në Figurën 5 të shënimit shoqëruar të RRRë "Vlerësim i Gjendjes së Ekonomive të Ballkanit Perëndimor gjatë Përballjes me COVID-19".

ofertë. Për aq kohë sa kufizimet në udhëtim dhe masat për distancimin social të jenë ende prezente, ndikimi negativ mund të zgjasë më shumë në sektorin e shërbimeve, i cili ka një kontribut veçanërisht të lartë në nivelin e përgjithshëm të punësimit në rajon - 75 përqind në Mal të Zi dhe rreth 50 përqind në vendet e tjera. Konsumi i familjeve gjithashtu do të preket nga remitancat më të ulëta: ato parashikohet të bien me 10 pikë përqindje nga viti në vit në rajon, ku Serbia dhe Mali i Zi ka të ngjarë të pësojnë rënie prej gati 20 përqind. Investimet gjithashtu pritet të bien në vitin 2020 për shkak të kufizimeve të likuiditetit si dhe pasigurisë së lartë, dhe Kosova do pësojë goditjen më të rëndë me një rënie prej 21.5 pikë përqindje, e përkeqësuar nga investimet e vonuara publike dhe investimet e ulëta të diasporës në pasuri të paluajtshme (Tabela A.1). Në Shqipëri, erozioni i mundshëm i të ardhurave të disponueshme dhe konsumit, veçanërisht konsumi i mallrave të qëndrueshëm, do të vonojë rindërtimin e nevojshëm për shkak të tërmetit. Eksportet e Ballkanit Perëndimor si për shërbime ashtu edhe për mallra parashikohet të ulen - rritja totale e eksporteve në vitin 2020 do të variojë nga -0.2 përqind në Maqedoninë e Veriut në -25 përqind në Shqipëri - për shkak të rënies së turizmit dhe kërkesës më të ulët për mallra nga BE dhe partnerët e tjerë tregtarë. Importet gjithashtu pritet të ngadalësohen në mënyrë të konsiderueshme.

**Figura 1. Rritja e PBB-së Reale, Dy Skenarët për 2020**



*Burimi:* Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore. Për Ballkanin Perëndimor, rritja e PBB-së reale është mesatarja e ponderuar. Për Shqipërinë, skenari para-COVID përfshin efektet e tërmetit dhe rindërtimit. Shiko Tabelën A.1 për një parashikim më të hollësishëm të rritjes së PBB-së reale dhe komponentëve të tij të shpenzimeve.

**Recesioni do të jetë veçanërisht i rëndë në Malin e Zi, Shqipëri dhe Kosovë për shkak të varësisë së tyre nga turizmi.** Në nivel global, sipas supozimit të fundit të UNËTO, rënia në numrin e turistëve ndërkombëtarë mund të arrijë deri në 30 përqind, shumë më e lartë se rënia globale prej 4 përqind e shënuar në vitin 2009.<sup>5</sup> Sipas skenarit bazë, Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi do përjetojnë rënie me 20-35 përqind të ardhurave nga turizmi për vitin 2020, dhe kjo do ketë impakt negative të ndjeshëm në rritjen ekonomike të tyre në vitin 2020 për shkak se për të tre vendet, të ardhurat e drejtpërdrejta dhe indirekte të turizmit vlerësohet se përbëjnë 15 deri më shumë se 25 përqind të PBB-së. Rimëkëmbja ekonomike në transport dhe turizëm gjithashtu pritet të jetë më graduale, kështu që rritja gjatë gjysmë së dytë të vitit nuk do të kompensojë humbjet e sezonit të verës. Vetëm turizmi kosovar mund të rifillojë më shpejt pas

<sup>5</sup> UNWTO. 2020. Numri i Turistëve Ndërkombëtarë Mund të Bjerë me 20-30% në 2020. 26 Mars, 2020. <https://www.unwto.org/neës/international-tourism-arrivals-could-fall-in-2020>

lehtësimet të kufizimeve të udhëtimit, pasi 80 përqind e eksporteve të shërbimit të tij të udhëtimit nxiten nga turizmi i diasporës.

**Integrimi më i thellë në zinxhirët globale të vlerës dhe varësia nga tregjet e BE-së identifikohet me ndërprerje në anën e ofertës dhe një rënie të konsiderueshme për industrinë dhe prodhimin e orientuar nga eksporti, veçanërisht për BH, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.** Ndërsa sektorët e orientuar në tregun e brendshëm ose të lidhur me shërbimet në internet - të tilla si bujqësia, informacioni dhe komunikimi, dhe shëndetësia - kanë më pak të ngjarë të preken drejtpërdrejt nga pandemia; industria përpunuese mund të ketë një rënie më të thellë në vitin 2020, nga rreth 6.5 përqind në BH deri në 9 përqind në Serbi. Në mënyrë të ngjashme, industria përpunuese, së bashku me ndërtimin, turizmin, tregtinë dhe pasuritë e paluajtshme, mund të tkurren me 11.5 përqind në T2 në Maqedoninë e Veriut.

**Zhvillimet negative në sektorin real do të përkeqësojnë disbalancat ekzistuese fiskale dhe të jashtme, veçanërisht për vendet me hapësirë të kufizuar fiskale, siç janë Kosova, Mali i Zi, dhe në një masë më të vogël Shqipëria.** Pas shumë viteve me tepricë, bilancet fiskale të BH parashikohet të kthehen me deficite, të cilat do arrijnë në -3.7 përqind të PBB-së. Në përgjithësi, deficitet fiskale mund të arrijnë vlera të krahasueshme me ato të pas-krizës globale financiare, deri në 4.7 përqind në Maqedoninë e Veriut, 5.4 përqind në Shqipëri dhe rreth 7 përqind në Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Raporti i përgjithshëm i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së në rajon pritet të arrijë në mbi 70 përqind të PBB-së, por nevojat e larta të financimit mund të zbuten nga rezervat ndërkombëtare, të cilat mbulojnë ekuivalentin e 3 deri në 6 muaj importe në të gjitha vendet në Rajon.

**Sipas skenarit negativ, rritja në Ballkanin Perëndimor do të mund të bjerë me rreth 5.7 përqind në vitin 2020, duke shkaktuar një recesion akoma më të rëndë sesa kriza globale financiare.** Nëse masat kufizuese zgjaten deri në gusht, Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi do të humbin pjesën më të madhe të sezonit të tyre të turizmit në vitin 2020. Kjo humbje mund të arrijë deri në gjysmën e të ardhurave të pritshme nga turizmi, duke përkeqësuar ritmin e rënies ekonomike. Projektionet për rritjen ekonomike të vitit 2020 për këto tre vende janë deri në 15 pp më të ulëta se në skenarin para-COVID 19.

**Një krizë më e gjatë mund të përkthehet në rritje më të ngadaltë afatmesme për Ballkanin Perëndimor për shkak të investimeve të kufizuara vendase dhe të huaja.** Duke pasur parasysh reduktimin e zgjatur të aktivitetit të biznesit, punësimit dhe të ardhurave, jo vetëm që konsumi në rajon mund të tkurret akoma më shumë me 2.8 përqind në vitin 2020, por edhe investimet mund të zvogëlohen me 7.7 përqind për shkak të pasigurisë, kufizimeve të financimit dhe hapësirës së kufizuar fiskale (Tabela A.1). Vendet që kanë varësi të madhe nga investimet e huaja direkte (IHD), si Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia, ku IHD-të përbëjnë më shumë se 7 përqind të PBB-së, janë në rrezik më të lartë të një përballjes me një ndalesë të papritur të IHD-ve. Rritja e produktivitetit të biznesit mund të ngadalësohet për një farë kohë për shkak se biznese që më parë kanë qenë productive detyrohen të mbyllen, humbjes së rrjeteve punëdhënës-punonjës, dhe investimet inovative por me rrezik më të madh nuk mund të financohen sepse bankat bëhen kundërshtuese ndaj rrezikut dhe investitorët ndërkombëtarë largohen drejt vendeve të sigurta. Presioni në llogaritë fiskale dhe ato të jashtme do të përkeqësohej akoma më tej.

**Gjatë periudhës afatmesme, rritja ekonomike pritet të rikthehet fuqishëm në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor pasi jeta dhe aktiviteti ekonomik gradualisht rikthehen në normalitet, megjithëse shpejtësia e rikuperimit do varet nga kohëzgjatja dhe intensiteti i pandemisë.** Në vitin 2021, normat e rritjes ekonomike pritet të rikthehen në nivelet para-COVID-19, përveç në Shqipëri, ku ajo mund të kapërcejë në 8.8 përqind, dhe në Kosovë, duke u forcuar në 5.2 përqind. Pritshmëritë janë për një rikthim

të besimit të konsumatorëve dhe investitorëve duke rritur konsumi dhe investimet private. Rimëkëmbja në investime dhe aktivitetit në sektorë jetik si shërbime, turizëm, ndërtim dhe energji, do të mbështesin krijimin e vendeve të punës. Në Shqipëri, rindërtimi do të jetë thelbësor për të stimuluar ekonominë në vitin 2021. Për Maqedoninë e Veriut, pranimi i saj kohët e fundit në NATO dhe ftesa zyrtare e Këshillit të BE-së për të hapur negociatat për anëtarësimin në BE (së bashku me Shqipërinë) duhet të ndihmojnë në përshpejtimin e rimëkëmbjes. Megjithatë, rikthimi i pritshëm i aktivitetit ekonomik bazohet në supozimin se përhapja e pandemisë do të zbehet në mënyrë efektive në gjysmën e dytë të vitit 2020.

## **Një pandemi e zgjatur do ta bënte gjithnjë e më të vështirë menaxhimin e krizës ekonomike që do të shpalose**

**Situata mund të përkeqësohet akoma më shumë.** Rreziku kryesor për Ballkanin Perëndimor është se, së bashku me një mjedis social dhe politik problematik, një pandemi e zgjatur e kombinuar me një recesion më të thellë në BE mund të bëjë gjithnjë e më të vështirë menaxhimin e krizës ekonomike që do të shpaloset. Përveç rritjes së kostove njerëzore dhe sociale, një pandemi më e gjatë do të përforconte përhapjen e efekteve globale nga kanalet e tregtisë, financiare dhe të mallrave. Zgjatja e saj do të intensifikonte gjithashtu sjelljen kundërshtuese ndaj rrezikut të investitorëve dhe rrjedhimisht kostot e huamarrjes, të cilat do të kishin kosto të konsiderueshme fiskale për vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë raporte të larta të borxhit të jashtëm ndaj PBB-së. Zhvillimet e pafavorshme të kursit të këmbimit mund të shtojnë më tej kostot e shërbimit të borxhit (Hapësira Informuese 1). Valët e ardhshme të shpërthimit të COVID-19 që kanë të nevojshme izolimin do të rrisin më tej pasigurinë ekonomike, si dhe kostot ekonomike dhe sociale. Përveç presionit në llogaritë fiskale dhe ato të jashtme, ekziston rreziku që masat reaguese ndaj krizës socio-ekonomike të mos jenë efektive në kontekstin e ri të distancimit social, shkallës jo të përsosur përdorimit të shërbimeve online të qeverisë dhe ndërprerjeve në funksionimin e administratave publike. Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë shtyrë zgjedhjet e tyre parlamentare të pranverës; në BH, Kosovë dhe Mali i Zi, paqëndrueshmëria politike mund t'i shtohet pasigurisë tashmë të lartë dhe të shaktojë shumë probleme aftësisë së qeverive për të reaguar.

### **Hapësirë informuese 1. Rreziq të Reja Globale**

**Perspektiva globale është shumë e pasigurt dhe do të varet së tepërmi nga koha e heqjes së masave kufizuese.** Megjithëse fillimisht numri i të prekurve në Evropë dhe Azinë Qendrore (ECA) ishte i ulët, rritja e shpejtë e rasteve të konfirmuara mund t'i detyrojë disa vende të zgjasin masat kufizuese aktuale për një kohë të konsiderueshme. Pika e infleksionit për rimëkëmbjen e ekonomisë do të jetë e ndryshme në vendet e rajonit. Masat kufizuese që synojnë të gadalësojnë përhapjen e virusit kanë shkaktuar ndërprerje të papritur të aktivitetit në shumë ekonomi të EAQ-s e kudo gjetkë. Modelet sektoriale sugjerojnë se mbyllja e bizneseve rrezikon një rënie prej më shumë se 2 pp nga rritja vjetore për çdo muaj që masat do të jenë në fuqi. Sidoqoftë, kjo qasje nuk merr parasysh shtrirjen e efekteve globale që mund të krijohen si rezultat i dobësisë të kërkesës së jashtme për shkak të masave kufizuese në vendet e tjera; ka të ngjarë që ndikimi të jetë edhe më i madh në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore duke patur parasysh hapjen e tij ndaj tregtisë dhe flukset financiare.


**Pandemia e koronavirusit ka trazuar tregjet financiare, vecanërisht tregjet e reja dhe ekonomitë në zhvillim (EMDE) të cilat po vuajnë nga rrjedhjet e flukseve dalëse drejt vendeve të sigurta.** Përhapja e shpejtë e pandemisë së koronavirusit në botë ka bërë që tregjet globale të kapitalit të zhyten, ndërsa një grup i madh kompanish të ulin vlerësimet për fitimet për shkak të rënies së kërkesës si dhe ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit. Asetet e EMDE-ve po i nënshtrohen një presioni të konsiderueshëm nga flukset dalëse të kapitalit të cilat janë më të larta krahasuar edhe me periudhën më të keqe të krizës globale financiare (Figura B.1.1) - megjithëse deri më tani rënia në EAQ ka qenë më pak e theksuar. Diferencat midis bonove sovraane dhe të korporatave janë në rritje, ndërsa pjesa më e madhe e tregjeve të reja dhe ekonomive në zhvillim kanë përjetuar rënie drastike të indekseve në tregun vendas të aksioneve dhe vlerave të monedhës. Tregjet mbeten të

paparashikueshëm; në Mars mesatarisht indeksi i paqëndrueshmërisë së VIX u trefishua. Shtrëngimi i mëtejshëm i kushteve të financimit mund të rrisë kostot e shërbimit të borxhit për tregjet në zhvillim, veçanërisht për ato me borxh të lartë si Shqipëria, Kroacia dhe Mali i Zi. Në ekonomitë me disbalanca të larta të jashtme, kjo mund të krijojë presion në bilancet e korporatave dhe të rrisë rreziqet e mbartura, të cilat nga ana tjetër mund të shkaktojnë mos kryerjen në kohë të pagesave dhe realizimin e detyrimeve të kontigjencës. Një recesion i tejzgjatur do të ndikonte negativisht në sektorët financiarë në Ballkanin Perëndimor, duke rritur kreditë me probleme dhe duke dëmtuar fitimet dhe rentabilitetin, veçanërisht për bankat që nuk janë të mirë-kapitalizuara. Nga ana tjetër, kjo do të limitonte aftësinë e bankave për të dhënë hua dhe mbështetur aktivitetin real si dhe do të dobësonte më tej konsumin dhe investimet. Ndikimi do të ishte më i rëndë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat aktualisht kanë akses minimal në kredi (Figura B.1.1D). Së fundmi, si rezultat i rritjes së lidhjeve financiare në rajon, stresi financiar ose bankar në një ekonomi mund të ketë pasoja serioze edhe në vende të tjera të rajonit.


**Përkeqësimi i tejzgjatur i sentimentit të investimeve mund të ketë implikime materiale për tregjet në zhvillim në EAQ, veçanërisht nëse do të kishte një ndërprerje të papritur të flukseve të kapitalit.** Erozioni i rëndë i besimit - i nxitur, për shembull, nga një përkeqësim i situatës nga koronavirusi – do të sillte rritje të flukseve dalëse të kapitalit nga tregjet në zhvillim dhe do të frenonte investimet, veçanërisht investimet e huaja direkte. Në varësi të kohëzgjatjes së pandemisë, IHD-të mund të bien nga 5 deri në 15 përqind në vitin 2020. Perspektiva e investimeve në tregjet në zhvillim, të cilat ishin në krizë që në fillim të vitit, ka të ngjarë të përkeqësohet më tej me ngadalësimin e shpenzimeve kapitale. Tregjet më të prekura do të jenë ato që do të kenë shpërthime më të mëdha të pandemisë ose ndërprerje të zinxhirit të furnizimit, ose që mbështeten kryesisht tek industrinë e udhëtimit dhe transportit dhe tek sektorë me përdorim intensiv të kapitalit, sic janë energjia dhe industrinë e teknologjisë moderne. Shumë korporata shumëkombëshe kanë nxjerrë paralajmërime mbi fitimet, ku parashikohet një rënie e të ardhurave mesatarisht deri në 10 përqind për firmat që operojnë në EAQ. Kjo pritet të zvogëlojë riinvestimin e fitimeve - një burim i rëndësishëm i IHD-ve në EAQ.

**Rreziku i një rënie të menjëhershme të remitancave do ta thellonte më tej recesionin ekonomik, veçanërisht për tregjet në zhvillim në Evropë, ku konsumi vetjak varet jashtëzakonisht shumë nga ky burim kritik i të ardhurave.** Ka të ngjarë që tregjet në zhvillim të përjetojnë rënie të fluksit të remitancave gjatë 2020-s pasi masat kufizuese të ndërmarra në vendet pritëse me qëllim frenimin e përhapjes së virusit mund të shkaktojnë humbje të vendeve të punës, duke i lënë emigrantët të papunë ose me leje. Përpara pandemisë, remitancat pritej të rriteshin në 4.2 përqind në vitin 2020-n në një numër të madh vendesh në zhvillim (Banka Botërore 2020). Kjo tani duket e pamundur: masat kufizuese kanë shkaktuar ndërprerje të shumë aktiviteteve ekonomike në vendet e diasporës, duke çuar në humbje të vendeve të punës dhe përdorim të të ardhurave të disponueshme, duke qenë se shpesh mungojnë rrjetat e mbrojtjes sociale për emigrantët. Gjithashtu, ka mundësi të shtohet presioni mbi remitancat për shkak të vështirësimit të aksesit në institucionet e transferimit të parave; disa prej operatorëve në këtë sektor janë mbyllur përkohësisht gjatë pandemisë.


**Figura B.1.1: Efektet e Pandemisë, në përqindje**



**C. Parashikimet Aktuale dhe Konsensuale për Rritjen e Investimeve në EAQ**



**D. Firmat që nuk kanë Akses në Kredi, sipas Rajoneve**



*Burimi:* Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve; Instituti i Financav Ndërkombëtare; Ekonomiksi Konsensual, Banka Botërore.

*Shënime:* A. Të dhënat datojnë që nga 31 Mars, 2020.

B. Datat për fillimin e secilit episod: COVID-19, 24 Janar, 2020; Kriza financiare globale, 5 Shtator, 2008. Modeli për flukset e portofolit përfshin vende për të cilat disponohen të dhëna si: Hungaria, Polonia, Turqia dhe Ukraina,. Vëzhgimi i fundit: 10 Prill, 2020.

**Marrja e masave të shpejta dhe të guximshme lehtësuese mund të pakësojë pasojat social-ekonomike të krizës, por politikbërësit po përballen me dilema dhe kompromise kritike**

Ndërkoh që të gjitha vendet kanë adoptuar masa për menaxhimin e krizës me qëllim zbutjen e efekteve të kërkesës mbi të ardhurat nga puna dhe falimentimin e firmave, vende si Serbia të cilat kanë më shumë amortizatorë fiskalë kanë mundur të financojnë programe më të mëdha mbështetëse. Që prej shpërthimit të COVID-19, shumë vende, përfshirë Ballkanin Perëndimor, kanë shpallur gjendjen e jashtëzakonshme. Megjithëse BH, Kosova dhe Mali i Zi nuk e kanë shpallur zyrtarisht gjendjen e jashtëzakonshme, ato kanë adoptuar masa të rrepta të distancimit social dhe izolimit në shtëpi. Gjithashtu, qeveritë e gjashtë vendeve kanë njoftuar masa fiskale dhe sociale për të mbështetur familjet dhe bizneset gjatë kësaj shtate, me vlera që variojnë nga 1 deri në 7 përqind të PBB-së, përfshirë mbështetjen buxhetore por jo garancitë (Tabela 1).

**Tabela 1. Masat Mbështetëse të Adoptuara nga Vendet e Ballkanit Perëndimor, në miliardë euro**

	Totali	Përqind e PBB-së
Shqipëri	0.4	2.4
BH	0.4	2.3
Kosovë	0.2	2.8
Mal i Zi	0.05	1.0
Maqedoni e Veriut	0.2	2.0
Serbi	3.2	6.7

*Burimi:* Ministrinë e Financave, përlogaritje të Bankës Botërore.

*Shënim:* Vlerësimet përfshijnë mbështetje buxhetore në 2020 por jo garancitë, të deklaruara deri në 22 Prill.

**Shumica e masave të prezantuara deri tani në rajon përqendrohen tek mbështetja e fluksit të parave të bizneseve për të reduktuar falimentimet dhe për të mbrojtur vendet e punës gjatë muajve të ardhshëm deri në heqjen e kufizimeve për shkak të COVID-19** (shiko Tabelën A.2). Këto masa janë hartuar me qëllim zbutjen e pasojave të menjëhershme social-ekonomike si rezultat i tkurrjes së kërkesës dhe ofertës gjatë fazës së parë të kësaj krize, ndërsa kufizimet për parandalimin dhe kontrollin e pandemisë COVID-19 janë ende në fuqi. Konkretisht, objektivi i tyre është ruajtja e të ardhurave dhe kapacitetit prodhues të sektorëve më të prekur të ekonomisë sepse mbyllja e përkohshme e bizneseve dhe transportit së bashku me kufizime të tjera rrezikojnë qëndrueshmërinë e bizneseve, p.sh., shërbime të transportit dhe mikpritjes, shitje me pakicë duke përjashtuar ushqimet, farmaci, disa shërbime personale dhe industrinë e prodhimit të mallrave të qëndrueshme. Për shembull, Tabela A.2 tregon se shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë adoptuar një kombinim masash afat-shkurtra për zbutjen e krizës, sic janë garantimi i aksesit për firmat në programe të subvencionimit të interesave të kredive, shtyrja e afatit të pagesave të taksave dhe kredive ose subvencionimi i pagave për firmat e prekura nga kriza në mënyrë që të shmangen pushimet massive nga puna. Masat tregtare synojnë kryesisht të ndalojnë eksportin e pajisjeve mjekësore ose produkteve ushqimore. Ndonëse disa masa tregtare mund të ndikojnë në zbutjen e pasojave të krizës, angazhimi për t'i mbajtur tregjet hapur për produkte thelbësore mund të shmang luhatjet e mëdha të çmimeve; kufizimet në eksport duhet të hartohen me kujdes për të evituar barrierat e panevojshme ndaj tregtisë dhe prishjen e zinxhirëve të furnizimit global. Gjithashtu, në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor ka patur rritje të përkohshme të ndihmës sociale për familjet në nevojë dhe pensionistët. Me heqjen e masave kufizuese do të nisë faza e dytë për zbutjen e krizës, dhe qeveritë do të duhet të mendojnë si të garantojnë një rihapje të sigurt dhe graduale të ekonomisë dhe të mbështesin kërkesën agregate për një rikuperim të shpejtë dhe të njëtrajtshëm.

**Masat e reagimit ndaj krizës të adoptuara deri më tani janë në përputhje me masat e marra në shumicën e vendeve të BE-së, por kushtet fillestare në vendet e Ballkanit Perëndimor e për rrjedhojë politikat e ndjekura janë të ndryshme.** Mbështetja për bizneset dhe vendet e punës, si dhe për më të dobtit, është në përputhje me politikat e adoptuara nga shumë vende të BE-së. Duke pasur parasysh natyrën e këtyre masave, ato do të drejtohen kryesisht tek bizneset formale dhe punëtorët. Për shembull, subvencionet e pagave për bizneset në Serbi, si në shumë vende të BE-së, kushtëzohen nga regjistrimi i punonjësve. Por tregjet e punës në Ballkanin Perëndimor janë të ndryshme: shkalla e punësimit është e ulët, ndërsa vetëpunësimi, punësimi me kohë të pjesshme dhe ai informal ndeshen rëndom. Shumë prej të ardhurave të shtresave në nevojë vijnë nga aktivitete informale; për shkak se shumë nga këta njerëz nuk kanë një punë formale dhe nuk janë përfshirë në programe të ndihmës sociale për shtresat e varfëra, ata nuk marrin mbështetjen e duhur. Këto karakteristika specifike të tregjeve lokale të punës duhet të merren parasysh gjatë zbatimit të masave për përbalimin e krizës dhe specifikimit të kriterëve të pranueshmërisë.

**Kohëzgjatja e pandemisë dhe pasiguria që lidhet me të ka krijuar dilema për politikëbërësit: masat optimale të hartuara për një krizë më të shkurtër dhe me rimëkëmbje të shpejtë mund të rezultojnë joefikase dhe të kushtueshme në rast se kriza zgjat.** Kohëzgjatja e krizës përcaktohet nga zhvillimi i pandemisë kështu që është e pasigurt. Pasiguria lidhur me kohëzgjatjen e krizës gjeneron compromise vendimtare në hartimin e politikave. Masat zbutëse afatshkurtra që synojnë të mbrojnë likuiditetin e firmave të prekura nga kriza mund të jenë shumë efikase në ruajtjen e të ardhurave gjatë muajve të parë të krizës. Por ato janë të kushtueshme dhe mund të bëhen të paqëndrueshme dhe joefektive nëse kriza zgjat, ndërsa likuiditeti i bizneseve mund të kthehet në pengesë për aftësinë paguese. Përfundimisht eliminimi i hapësirës fiskale do t'i detyronte autoritetet të zvogëlojnë mbështetjen e tyre, duke i detyruar firmat që kanë përfituar ndihmë të mbyllën ose të pushojnë punëtorët. Gjithashtu, do të sillte shterimin e burimeve që mund të ishin përdorur për programe afatgjata ose stimuj ekonomikë gjatë fazën së rimëkëmbjes. Ashtu si shumica e ekonomive në tregjet në zhvillim, vendet në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht ato me hapësirë të kufizuar fiskale, duhet të vlerësojnë me kujdes vendimet e tyre.

**Në mënyrë që rikuperimi ekonomik të jetë sa më i qëndrueshëm në periudhë afatmesme, disa vende të rajonit duhet të punojnë për t'i bërë ekonomitë e tyre më rezistente ndaj goditjeve; të gjitha vendet duhet të vazhdojnë gjithashtu reformat strukturore me qëllim rritjen e produktivitetit.** Disa prej vendeve të Ballkanit Perëndimor hynë në këtë krizë me disbalanca të brendshme dhe të jashtme të larta.<sup>6</sup> Madhësia e borxhit publik në Shqipëri dhe Mal të Zi zvogëlon hapësirën fiskale për reagime ndaj krizës. Gjithashtu, deficitet e llogarisë korrente janë të larta në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi, duke rritur ekspozimin e tyre ndaj financimit të jashtëm. Kriza e COVID-19 demonstroi edhe një herë se ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe të sektorit financiar është thelbësore për përmirësimin e fleksibilitetit rajonal ndaj goditjeve ekonomike; stabiliteti është një kusht i domosdoshëm për të mbështetur rritjen e fuqishme ekonomike në periudhë afatmesme. Rritja e rezistencës ndaj goditjeve varet gjithashtu nga rritja e produktivitetit. Modelet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit ekonomik në rajon varen kryesisht nga përshtetimi i reformave strukturore të cilat do t'i japnin hov produktivitetit, si: forcimi i institucioneve shtetërore që mbrojnë sundimin e ligjit; mbrojtja e konkurrencës në sektorin privat; adresimi i mospërputhjeve përsa i përket aftësive në tregun e punës; dhe përmirësimi i shërbimeve publike me qëllim forcimin e kapitalit njerëzor. Kryerja e reformave strukturore do t'i hapë rrugë një zhvillimi më të fortë, më të njëtrajtshëm dhe më të qëndrueshëm, duke garantuar kështu konvergencë më të shpejtë me nivelet e të ardhurave të BE-së dhe rezistencë më të lartë ndaj goditjeve të jashtme si pandemia COVID-19.

---

<sup>6</sup> Shiko gjithashtu "Harta e të dhënave për ndjeshmëritë relative ndaj COVID-19 të Ballkanit Perëndimor " në Figurën 5 të shënimit shoqëruar të RRE "Vlerësim i Gjendjes së Ekonomive të Ballkanit Perëndimor gjatë Përballjes me COVID-19".



**Tabela A.1. Rritja e PBB-së Reale dhe Shpenzimeve sipas Komponentëve në vitin 2020, Dy Skenarët**

	Shqipëria			BH			Kosova		
	Para-COVID-19	Skenari Bazë	Skenari Negativ	Para-COVID-19	Skenari Bazë	Skenari Negativ	Para-COVID-19	Skenari Bazë	Skenari Negativ
Rritja e PBB-së Reale	3.3	-5	-6.9	3.4	-3.2	-4.2	4.1	-4.5	-11.3
Konsumi	3.1	-1.6	-2.2	3.3	-2.7	-3.8	3.2	1.1	-0.6
Investimet	7.7	1	0.8	1	-6.2	-7.1	3.8	-21.5	-28.5
Eksporet	2.7	-25	-30	3	-8.8	-10	4	-12.2	-25.5
Importet	4.6	-9.5	-10.6	5	-6.5	-7.5	2.2	-6.8	-8

	Mali i Zi			Maqedonia e veriut			Serbia		
	Para-COVID-19	Skenari Bazë	Skenari Negativ	Para-COVID-19	Skenari Bazë	Skenari Negativ	Para-COVID-19	Skenari Bazë	Skenari Negativ
Rritja e PBB-së Reale	3.2	-5.6	-8.9	3.6	-1.4	-3.2	3.9	-2.5	-5.3
Konsumi	2.9	-3.6	-4.8	4.3	0.6	-0.3	5.7	-2.3	-3.5
Investimet	0	-8.8	-13.7	8.0	-0.4	-2.7	5.3	-5.2	-7.7
Eksporet	4.1	-18.5	-27.8	7.4	-0.2	-2.9	4.9	-10.2	-18.5
Importet	1.9	-12.4	-17.7	9.4	1.9	0.1	7.6	-9.7	-15.1

	Ballkani Prëndimor		
	Para-COVID-19	Skenari Bazë	Skenari Negativ
Rritja e PBB-së Reale	3.7	-3.1	-5.7
Konsumi	4.4	-1.7	-2.8
Investimet	4.8	-5.3	-7.7
Eksporet	4.5	-11.3	-17.6
Importet	6.3	-7.6	-10.9

*Burimi:* Përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

*Shënim:* Për Shqipërinë, skenari Para-COVID përfshin dhe efektet e tërmetit dhe rindërtimit.

**Tabela A.2. Masat afatshkurtra për Zbutjen e Ndikimit Social dhe Ekonomik të COVID-19, Ballkani Perëndimor<sup>7</sup>**

VENDI	FISKALE DHE TË LIDHURA ME TREGTINË	MONETARE DHE FINANCIARE	MBROJTJE SOCIALE
<b>SHQIPËRIA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtyrje e afatit të dorëzimit të deklaratës tatimore për biznesin e vogël nga 31 Mars në 1 Qershor dhe riskedulim të pagesës së tatimit mbi fitimin për bizneset e prekuara negativisht.</li> <li>Heqje e aplikimit të interesit për vonesa në pagesa</li> <li>Rritja e buxhetit për ministrinë e shëndetësisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Skemë garancie për kreditë për NVM-të për të paguar pagat</li> <li>Bankat lejohen të shtyjnë pagesat e kësteve të kredive për ata që preken negativisht nga COVID-19, pa aplikim të penalteteve rregullatore.</li> <li>Ulje e normës bazë të interesit të Bankës Qendrore në një nivel të ulët historik prej 0,5% dhe normës së kredisë njëditore në 0.9%</li> <li>Injektivim i likuiditetit të pakufizuar në sektorin bankar për të siguruar funksionimin normal të sistemit të pagesave elektronike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritje të buxhetit për transferata sociale për të varfërit, bizneset e vogla dhe të papunët</li> <li>Riskedulim i pagesave të qirave për familjet e dhe bizneset e vogla të prekura negativisht.</li> </ul>
<b>BH</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organe koordinuese për stabilizimin ekonomik.</li> <li>Procedura për prokurime urgjente me proces të rregulluar;</li> <li>Afatet për dorëzimin e formularëve tatimore u zgjatën deri më 30 Prill (në RS dhe FBH); dhe për sipërmarrësit deri më 31 maj (FBH). RS prezantoi shtyrjen e taksave (tatimin mbi fitimin) në 30 Qershor; dhe pagesë të mëvonshme me këste deri në fund të vitit 2020.</li> <li>Pagesa njëherazi e taksës për të ardhurat totale të mikro sipërmarrësve (1 ose 2 punonjës) u reduktua me 60%.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Moratorium për pagesën e kësteve të kredive ndaj bankave të investimeve dhe zhvillimit;</li> <li>Kantoni i Sarajevës uli me 50% qiratë për pronat në pronësi të tij.</li> <li>Fonde garancie për rikuperimin e ekonomisë së FBH;</li> <li>Garanci dhe fond kreditimi për NVM;</li> <li>Banka e zhvillimit e F BiH të krijojë një linjë krediti për përmirësimin e likuiditetit të kompanive biznesi i të cilave preket nga Covid-19;</li> <li>Agjencitë bankare kanë njoftuar një moratorium gjatshëmujor të shlyerjes së kësteve të kredive për ristrukturimin e rregullimeve të kredive për individët dhe personat juridikë, për të cilët është konstatuar se kanë rrethana të rënuara për pagesën e kësteve të kredive për shkak të COVID-19. RS prezantoi një moratorium tre-mujor për pagesën e kësteve të kredive të IDB për personat juridikë dhe sipërmarrësit</li> <li>FBH ka miratuar Ligjin mbi pasojat negative ekonomike të pandemisë</li> <li>Qeveria e F BiH ka miratuar ribalancimin e buxhetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në RS qeveria vendosi të krijojë një fond kompensimi për të mbuluar PIT dhe SSC për rreth 40,000 punëtorë në sektorët që janë mbyllur me vendimi të qeverisë, për muajt Mars, Prill dhe Maj. Në FBH qeveria vendosi të krijojë një fond stabilizimi për të mbuluar kontributet mbi pagën minimale për ata që preken nga COVID-19</li> <li>Fond për mbulimin e kostos së kujdesit shëndetësor në RS</li> <li>Fond për ndihmë për njësitë e vetëqeverisjes lokale në RS</li> </ul>
<b>KOSOVA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjitha afatet e dorëzimit të deklaratave tatimore dhe pagesës së taksave direkte dhe indirekte janë shtyrë në 30 Prill, me mundësinë e një zgjatjeje të mëtejshme.</li> <li>Shtyrje e kërkesave të raportimit financiar deri më 30 Prill</li> <li>Heqja e tarifës 100% për lëndët e para nga Serbia dhe BH</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vonesat në pagesat të kësteve të kredive të mos reflektohen në një zbritje në vlerësimin e kredisë në regjistrin e kredive të administruar nga Banka Qendrore deri më 30 Prill</li> <li>Pezullim të penalteteve për vonesat në pagesat e interesit deri më 30 prill, objekt i verifikimit rast pas rasti nga bankat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pezullimi i të gjitha procedurave të verifikimit për pensionet dhe përfitimet e ndihmës sociale deri në një njoftim tjetër.</li> <li>Pagesë e para kohe e pensioneve, përfitimeve sociale dhe subvencioneve bujqësore.</li> <li>Pagesë shtesë prej €30 në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale më të ulët se €100 (3 muaj);</li> </ul>

<sup>7</sup> Tabela përfshin masat e njoftuara deri më 24 Prill, 2020. Masat specifike të lidhura me shëndetin nuk janë përfshirë.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Heqje e TVSH-së dhe taksave doganore për grurin dhe miellin</li> <li>• Sigurimi i shtesës mbi pagë prej €300 për punëtorët e sektorit publik në sektorë thelbësorë të cilët ekspozohen drejtpërdrejt ndaj rrezikut të infeksionit (2 muaj)</li> <li>• Pagesë shtesë prej €100 për punonjësit e dyqaneve ushqimore, furra buke dhe farmaci (2 muaj)</li> <li>• Rritje e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</li> <li>• Mbështetje për eksportuesit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje financiare për kompanitë në vështirësi financiare si rezultat i situatës së emergjencës (mbështetje për të paguar pagat, kontributet e sigurimeve, qiratë)</li> <li>• Sigurimi i kredive pa interes për ndërmarrjet publike (shlyerja nga fundi i vitit 2020);</li> <li>• Sigurimi i mbështetjes financiare për Komunitet dhe Republikës së Kosovës</li> <li>• Garantim i likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet, të vetëpunësuarit dhe shoqëritë tregtare që plotësojnë kriteret</li> <li>• Mbështetje financiare e disponueshme për kompanitë që regjistrojnë punonjës me kontrata pune të paktën një (1) vit gjatë situatës së emergjencës së shëndetit publik, nga €130 për dy muaj pas regjistrimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pagesë së asistencës mujore për punonjësit që humbin vendin e punës për shkak të shpërthimit të virusit.</li> <li>• Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale (3 muaj)</li> <li>• Pagesë e asistencës mujore prej 130 € për qytetarët me kushte të rënda sociale ose të deklaruar si të papunë nga një institucion kompetent, të cilët nuk janë përfytyer të ndonjë ndihme mujore (Prill, Maj dhe Qershor)</li> <li>• Mbështetje e inisiativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë.</li> </ul>
<b>MALI I ZI</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtyrja e pagesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributeve sociale; ristrukturim i detyrimeve të borxhit tatimor për 90 ditë për të gjitha firmat.</li> <li>• Shtyrje me 90-ditë e pagesave të qirave për pronat shtetërore për personat natyrorë dhe bizneset</li> <li>• Subvencione për paga prej 100% të pagës minimale për 2 muaj dhe përjashtim i plotë nga taksat dhe kontributet për pagën minimale në sektorët e bllokuar.</li> <li>• Subvencione për paga deri në 50% të pagës minimale për sektorët e tjerë të prekur</li> <li>• Subvencione për paga prej 75% të pagës minimale për 6 muaj për punonjësit e raportuar rishtazi (për të inkurajuar formalizimin tregut të punës)</li> <li>• Subvencione për firmat për energjinë elektrike</li> <li>• Pezullimi i pjesës së ndryshueshme të të ardhurave për punonjësit e qeverisë qendrore</li> <li>• Mbështetje për sektorin e bujqësisë</li> <li>• Rritja e pagave për punonjësit e shëndetësisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Linja e re e kredisë IDF prej €120 milion kryesisht të shënjestrar për MSME-të, norma e interesit 1.5%, deri në 3 milion euro kredi, me 2 vjet periudhë mospagimi dhe deri në 8 vjet maturim.</li> <li>• Shtyrje e pagesave të kësteve të kredive për 90 ditë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje me pagesë njëherë prej 50 euro për person për pensionistët, qytetarët e shtresave vulnerabël dhe ata të papunë</li> <li>• Subvencione të energjisë elektrike për familjet në nevojë</li> </ul>
<b>MAQEDONIA E VERIUT</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ulja e interesit dhe tarifave parafiskale</li> <li>• Pezullimi i përkohshëm i pagesës së tatimit mbi të të ardhurat personale dhe pagesës paradhënie të tatimit mbi fitimit për taksapaguesit që fitojnë të ardhura nga vetëpunësimi për muajt Mars, Prill dhe Maj 2020, veçanërisht në aktivitetet e furnizimit të ushqimeve, turizmit dhe transportit, por gjithashtu i zbatueshëm për sektorët e tjerë të prekur</li> <li>• Ulje e normës së interesit për detyrimet e prapambetura dhe mbipagesat e tatimeve</li> <li>• Mbështetje për të mbrojtur vendet e punës: transferata direkte cash për ndërmarrjet që</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje e drejtpërdrejtë financiare për MSME-të të cilat humbasin aftësinë paguese [??] për shkak të krizës së koronavirusit</li> <li>• Ulja e normës bazë të interesit të Bankës Qendrore (BQ) nga 2 në një nivel të ulët historik prej 1,75 përqind</li> <li>• Ndryshime të përkohshme në kushtet e kredive</li> <li>• Ulja e normave të interesit të ndëshkimit për ndërmarrjet dhe individët</li> <li>• Rivendosija e kërkesës për rezervë jo standarde</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Subvencione për kontribute sociale për kompanitë që plotësojnë kriteret në sektorët e turizmit, transportit, hotelierisë dhe kompani të tjera të prekura për muajt Prill, Maj dhe Qershor. Deri në 50 përqind të kontributeve të pagës mesatare të paguar në vitin 2019</li> <li>• Përjashtimi nga pagesa e qirasë për përfytyerit e banesave sociale</li> <li>• Përfitim në para për qytetarët që kanë humbur vendin e punës (50% e pagës mesatare të punonjësve)</li> </ul>

	<p>plotësojnë disa kritere, për t'u përdorur për të paguar pagat dhe për t'i mbajtur punëtorët të punësuar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndalimi i përkohshëm i fillimit të procedurave të falimentimit</li> <li>• Ulje e pagave për të gjithë zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar, të cilëve do t'u paguhet paga minimale</li> <li>• Heqja e shpërblimit për anëtarët e bordeve ekzekutive dhe mbikëqyrëse dhe komitetet gjatë periudhës së krizës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjatje e afatit për depozitimin nga bankat të Raporteve të tyre të para të brendshme të Vlerësimit të Likuiditetit</li> <li>• Heqja e tarifave për tërheqjen dhe kthimin e parasë cash në kasafortën qendrore të BQ-së</li> <li>• Ngrirje e përkohshme e riklasifikimit të NPL-ve.</li> <li>• Kredi me normë zero interesi për NVM-të të dhëna përmes Bankës së Zhvillimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Relaksim i përkohshëm i kritereve për të aplikuar për ndihmë sociale</li> <li>• Përrjashtimi nga pagesa e qirasë për përfituesit e banesave sociale.</li> </ul>
<b>SERBIA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Moratorium për pagesat tatimore të subjekteve në vështirësi financiare</li> <li>• Kontroll i çmimeve për disa produkte mjekësorë dhe ushqime bazë</li> <li>• Ndalimi i eksportit të disa ilaçeve dhe produkteve medicinale, ushqimit dhe produkteve bujqësore</li> <li>• Plani i stimulit fiskal të ofrojë rreth 5.2 miliardë euro (nga të cilat 2.1 miliardë euro janë garanci për kredi) në shtyrjen e taksave; subvencione në para dhe kredi dhe garanci për bizneset</li> <li>• Shtyrje e pagesave të vonuara të tatimit mbi të ardhurat personale dhe sigurimeve shoqërore deri në 2021.</li> <li>• Mbulimi i pagave për 3-muaj në mikrondërmarrje NVM</li> <li>• Mbështetje për ndërmarrjet e mëdha: 50% të pagës minimale për të gjithë punonjësit, kontrata e të cilëve përfundoi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ulja e normës bazë të interesit të BQ nga 2.25% në 1.5%</li> <li>• BQ filloi operacione të rregullta për këmbime valutore sëap dhe repo për të siguruar likuiditet shtesë (në Mars u siguruan mbi 400 milion euro, 0.9% e PBB-së)</li> <li>• Moratoriumi për shlyerjen e borxheve për të gjitha bizneset dhe individët</li> <li>• Mbështetje përmes Fondit të Zhvillimit</li> <li>• Skema e garancive për kreditë e dhëna nga bankat.</li> <li>• Moratoriumi për pagimin e dividendëve dhe humbjen e tatimit mbi dividendët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pagesë njëherë në Prill për pensionistët (rreth 40 dollarë për person)</li> <li>• Transferim para cash prej 100 euro për të gjithë qytetarët.</li> </ul>